



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.10.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, montimi dhe servisi i kondicionerëve në shkollë", Nr. i prokurimit-632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-092-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., e dt.20.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, montimi dhe servisi i kondicionerëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-092-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.10.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **13.10.2025**;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K., me dt.20.10.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe servisi i kondicionerëve në shkollë", Nr. i prokurimit- 632-25-6413-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-092-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë pas kërimit të sqarimeve shtesë me nenin 72, të LPP-së, ka sjellë katalogun për pozicionet për të cilat pretendoni ju;

Pretendimi juaj është i pa bazuar sepse ju jo vetëm nuk keni plotësuar pjesën e formularit ku kërkohet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga lideri (shënohet edhe njëherë cili është lideri) por edhe e keni fshirë këtë pjesë të formularit;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gjataj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;